

  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 23/2019 (JR)  
Nr. 23/2 regj.

Tiranë, më 08.06.2020

**SHPALLJE**  
**E**

**NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË GJYQËSORE PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se ditën **e mërkurë, në datën 22.07.2020, ora 10:00**, do të gjykohet në seancë gjyqësore publike çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri 23/2019, datë 08.05.2019, për ankimin që Komisioneri Publik ka bërë kundër vendimit nr. 112, datë 04.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Dritan Peka.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses përbëhet nga gjyqtarët:

<b>Kryesuese e Trupit Gjykses</b>	<b>Natasha Mulaj</b>
<b>Relatore e Çështjes</b>	<b>Rezarta Schuetz</b>
<b>Gjyqtar</b>	<b>Sokol Çomo</b>
<b>Gjyqtar</b>	<b>Luan Daci</b>
<b>Gjyqtar</b>	<b>Ardian Hajdari</b>

Bazuar në nenin 460 pika 5 e Kodit të Procedurës Civile kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjykimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit të deklaruara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si dhe të dhënat elektronike të Institucionit të Komisionerëve Publikë.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES**

**GJYQTARE**  
**NATASHA MULAJ**



